

UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË SH.A

Rregullat/Procedurat/Dokumentacioni për Pikë lidhje në rrjetin e Furnizimit me Ujë të Pijshëm dhe Pikë shkarkimi në rrjetin e Kanalizimeve të Ujrave të Zeza, modifikimin e tyre, paisjen me Akt – Kolaudimi

1. BAZA LIGJORE

1.1 Rregullat për miratimin, projektimin, tarifimin, zbatimin apo modifikimin e pikave të lidhjes dhe/ose shkarkimit, me rrjetin publik të ujësjellësit dhe/ose kanalizimeve, bazohen dhe interpretohen sipas përcaktimeve në Rregulloren “Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjellës - kanalizimeve sh.a.”, miratuar me Vendimin nr.1304, datë 11.12.2009 të Këshillit të Ministrave, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 216, datë 13.4.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” në veçanti dhe në përgjithësi në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

2. RREGULLAT DHE UDHËZIMET E PËRGJITHSHME

2.1 Miratimi, projektimi dhe tarifimi i tubacionit lidhës dhe pikave të lidhjes dhe/ose shkarkimit, me rrjetin e ujësjellësit dhe/ose kanalizimeve, bëhet sipas përcaktimeve në Vendimin nr.1304, datë 11.12.2009 të Këshillit të Ministrave, pjesa e dytë “Rregullore e sistemit të furnizimit me ujë” dhe pjesa e tretë “Sistemi i Kanalizimeve”.

2.2. Projekti i furnizimit me ujë do të hartohet i shoqëruar me:

- *Preventivin nr.1*, që përfshin zërat e punimeve për realizimin e pikës së lidhjes me rrjetin publik të furnizimit me ujë dhe/ose pika e shkarkimit me rrjetin e kanalizimeve, shtrimin e tubacionit lidhës deri në pikën e takimit me sistemin e brendshëm të furnizimit me ujë të objektit të kërkuarit, dhe
- *Preventivin nr.2*, ku përfshihen vetëm zërat për realizimin e pikës së lidhjes me rrjetin publik të furnizimit me ujë dhe/ose pikës së shkarkimit me rrjetin publik të kanalizimeve.

2.3. Projekti i shoqëruar me Preventivin nr.1 do të zbatohet nga strukturat e UKT sh.a në ato raste kur aplikuesi që kërkon pikë lidhje dhe/ose shkarkimi është individ/person fizik, i cili është në pamundësi teknike dhe profesionale të zbatojë projektin për shtrimin e tubacionit lidhës nga pika e lidhjes/ pika shkarkimit deri tek sistemi i brendshëm i furnizimit me ujë. Zbatimi i projektit sipas Preventivit nr.1, kryhet nga UKT sh.a, pasi është paguar nga individi/kërkues apo personi fizik.

2.4. Projekti i shoqëruar me Preventivin nr.2, të pikës së lidhjes dhe/ose shkarkimit do të zbatohet nga strukturat e UKT sh.a. Kur kërkuesi është subjekt juridik (në cilësinë e ndërtuesit, zhvilluesit apo nënkontraktorit të tyre), me kapacitetet e duhura teknike (vlerësuar sipas dokumentacionit të depozituar) ai zbaton pjesën e mbetur të projektit që përbëhet nga tubacioni lidhës që bashkon segmentin nga pika e lidhjes/shkarkimit (që kryhet nga UKT) deri në pikën e takimit me sistemin e brendshëm të furnizimit me ujë dhe/ose shkarkimit të ujrave të ndotura, për objektin që kërkohet të lidhet. Në këto raste, zbatimi i punimeve sipas zërave të Preventivit nr.2 do të realizohet nga UKT, vetëm pas kryerjes së pagesës sipas këtij preventivi dhe shtrimit të tubacionit lidhës nga subjekti juridik kërkues deri te pika e lidhjes/shkarkimit.

2.5. Pavarsisht parashikimeve në pikat 2.1, 2.2, dhe 2.3, në çdo rast, punimet e parashikuara Preventivin nr.2, duhet të realizohet domosdoshmërisht nga strukturat e UKT sh.a në përputhje me parashikimet në vendimin nr.1304, datë 11.12.2009 të Këshillit të Ministrave, pjesa e dytë, pika 2, “Rregullore e sistemit të furnizimit me ujë”, paragrafi 2.3 “Pika e lidhjes së furnizimit me ujë të pronave të përdoruesve” dhe pjesa e tretë “Sistemi i Kanalizimeve”, pika 1.4 “Detyrimet për lidhjen dhe përdorimin e kanalizimeve të ujërave të ndotura”.

2.6.Rehabilitimi, rinovimi, ndërtimi dhe modifikimi, mirmbajtja apo çmontimi i pikës së lidhjes me rrjetin publik të furnizimit me ujë dhe pikës së shkarkimit në rrjetin publik të ujrave të ndotura, në rastet e ndryshimit të kushteve të furnizimit dhe/ose shkarkimit, do të realizohet nga strukturat e UKT sh.a, në përputhje me kushtet teknike të projektimit dhe zbatimit, sipas prcaktimeve në Vendimin nr.1304, datë 11.12.2009 të Këshillit të Ministrave.

2.7.Zbatimi i projektit të lidhjes me rrjetin publik shpërndarës të furnizimit me ujë dhe/ose shkarkimit me rrjetin publik të kanalizimeve të ujrave të ndotura do të realizohet nga strukturat e UKT sh.a, në përputhje me kushtet teknike të projektimit dhe zbatimit sipas kompetencave funksionale, vetëm pas kryerjes së pagesës nga subjekti kërkues, në bazë të Preventivit nr.1 për individët/personat fizikë kërkues ose sipas Preventivit nr.2 për subjektet juridikë (ndërtues/zhvillues ose nënkontraktues të tyre). Konfirmimi i projektit dhe preventivit do të bëhet me shkresë.

2.8.Projekti dhe preventivi i punimeve për lidhjen e objekteve me rrjetin e furnizimit me ujë dhe/ose shkarkimit të ujrave të ndotura, hartohen nga Departamenti Inxhinierik/Drejtoria Teknike në përputhje me kushtet teknike të projektimit dhe zbatimit, referuar çmimeve të manualit të ndërtimit të miratuar me vendim të këshillit të ministrave. Projekti i plotë, sipas zërave të Preventivit nr.1 që përfshin rrjetin nga pika e lidhjes me sistemin publik të ujësjellësit dhe/ose nga pika e shkarkimit të ujrave të ndotura deri në rrjetin e brendshëm të subjektit kërkues do të jetë dokumenti, në bazë të të cilit do të kontrollohen punimet e kryera nga palët e treta (subjektet juridikë kërkues, zhvillues, ndërtues, nënkontraktorë të tyre) për realizimin e pjesës tjetër të skemës së furnizimit me ujë dhe/ose shkarkimit të ujrave të KUN. Mbikëqyrja dhe kolaudimi i zbatimit të këtij projekti do të bëhet nga strukturat e UKT sh.a.

2.9.Shërbimi me pikë lidhje dhe pikë shkarkimi do të realizohet nga strukturat e UKT sh.a, vetëm pasi të jetë kryer pagesa e vlerës së preventivit (në bazë të konfirmimit të Departamenti Inxhinierik), vlerës së kontratës/ve të furnizimit me ujë të objektit (sipas konfirmimit të Departamentit të Shitjes) si dhe marrja e njoftimit nga subjekti kërkues. Në përfundim të punimeve, strukturat e UKT sh.a mbajnë aktet përkatëse, ku do të konfirmohet zbatimi i punimeve sipas Kushteve Teknike të Zbatimit dhe Projektit.

3. PROCEDURA E APLIKIMIT DHE DOKUMENTACIONI QË DUHET TË DEPOZITOHET NGA SUBJEKTET KËRKUES/APLIKUESI

3.1 Aplikuesit (subjektet zhvillues/investitor/ndërtues/individë apo palë të treta të nënkontraktuar prej tyre) që kërkojnë miratimin, projektimin dhe zbatimin e pikave të lidhjes dhe/ose pikave të shkarkimit, me rrjetin publik të ujësjellësit dhe/ose të kanalizimeve, duhet të aplikojnë me kërkesë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të UKT sh.a, për hartimin e projektit dhe realizimin e pikës së lidhjes për furnizimin me ujë dhe/ose të shkarkimit në sistemin e kanalizimeve dhe lidhjen e kontratës provizore dhe/ose definitive në varësi të stadi të zhvillimit, duke depozituar (në dy kopje) dokumentacionin si vijon:

- Kërkesë për pikë lidhje të furnizimit me ujë dhe/ose pikë shkarkimi në sistemin e kanalizimeve të rrjetit të UKT sh.a në emër të zhvilluesit/investitorit/ndërtuesit. (Në kërkesë duhet të specifikohet, nëse pika e lidhjes kërkohet provizore apo definitive dhe destinacioni i përdorimit të ujit);
- Dokument identifikimi të administratorit/ortakëve të zhvilluesit/ndërtuesit, në rastin, kur është person fizik ose të përfaqësuesit të tij, kur është person juridik, kopje të NUIS; adresa zyrtare për komunikimin elektronik; adresë të saktë të selisë për dërgimin e njoftimeve.
- Leja e ndërtimit dhe planvendosja e miratuar e objektit, në shkallë 1:500 (fotokopje), në rastet kur leja është dhënë nga ish komunat të shoqërohet me planvendosjen e objektit të marrë nga harta elektronike;
- Leje zhvillimi dhe planvendosja me azhornimet fillestare të rrjetit inxhinierik (nëse ka);

- Çertifikatë pronësie për truallin që zhvillohet, shoqëruar me HTR (hartë treguese të regjistrimit) dhe kartelën e pasurisë së dhe kartelën e pasurisë së paluajtëshme të 30 ditëve të fundit, për ndërtimet individuale.
- Kontratë sipërmarrje, lidhur nga zhvilluesi/investitori/ndërtuesi me pronarin e truallit dhe gjithë dokumentacioni shoqëruar bashkëlidhur saj.
- Akt kontroll spostimi të rrjetit inxhinierik, nëse është kërkuar në azhurnimin fillestar;
- Deklaratë për marrjen përsipër të detyrimeve debitore (nëse rezultojnë) për kontratat e furnizimit me ujë të objekteve të shembura ose jo, që ndodhen brenda territorit për të cilin është marrë leje zhvillimi/ndërtimi;
- Dokument pronësie ose kontrate shitblerje apo vërtetim i aplikimit për legalizimin e objektit, për të cilin kërkohet realizimi i pikës së lidhjes me rrjetin e furnizimit me ujë dhe/ose shkarkimit në sistemin e kanalizimeve (në rastet kur nuk disponon leje ndërtimi);
- Mandat pagese të tarifës paraprake për pikë lidhje (10 000 (dhjetë mijë) lekë për objektet mbi 3 (tre) kate dhe të vlerës 5 000 (pesë mijë) lekë për objektet deri në 3 (tre) kate, pagesë e cila mund të kryhet në një nga numrat e llogarisë bankare të UKT sh.a në
 - BKT:403003524;IBAN:AL1020511038003524CLPBCLALLB;
 - Credins Bank:53718;IBAN:AL2921211016000000000053718;
 - RaiffeisenBank:30003376;IBAN:AL74202111780000000030003376.
- Deklaratë e zhvilluesit/investitorit/ndërtuesit, që gjithë veprimet do të kryhen dhe kontrata do të lidhet vetëm në emër të tij.
- Për lidhjen e kontratave definitive të furnizimit me ujë, në rast se kërkesa/aplikimi është për pikë lidhje dhe/ose pikë shkarkimi definitive të subjekteve ndërtues, depozitohet edhe: - *Lista emërore (emër/atësi/mbiemër) me të dhëna të sakta për adresën e objektit dhe adresatën e njësive të godinës së ndërtuar (nr.apartamenti, kati, destinacion familjar/privat);- Dokument pronësie dhe/ose kontratë shitblerje dhe/ose kontratë porosie dhe/ose kontratë për klering dhe/ose kontratë shkëmbimi dhe/ose kontratë dhurimi dhe/ose kontratë e lidhur mes zhvilluesit/investitorit dhe pronarit të truallit mbi të cilin është ndërtuar objekti), të lidhura përpara noterit ndërmjet subjektit zhvillues/investitor dhe konsumatorit final për çdo apartament dhe njësi private; - Dokument i vlefshëm identifikimi për çdo konsumator final (fotokopje e ID dhe/ose pasaportë biometrike); - Deklaratë e konsumatorit final që pranon të lidhë kontratën e furnizimit me ujë; Leja e ndërtimit ose në mungesë të saj dokument nga ASHK dhe/ose njësia e vetqeverisjes vendore;Planimetri e vendosjes së objektit;Kopje të projektit të miratuar për pikë lidhje provizore të furnizimit me ujë dhe/ose pikë shkarkimi në sistemin e kanalizimeve (në rast se ka).*

3.2 Për objektet 1 – 3 kate, Aplikuesit duhet të depozitojnë pranë Njesisë Zonale ose Drejtorisë Rajonale pjesë e të cilës janë, vetëm në 1 (një) kopje të dokumentacionit që përbëhet nga - *Kërkesa me shkrim për pikë lidhje të furnizimit me ujë dhe/ose shkarkimi në sistemin e kanalizimeve dhe për lidhje kontrate, ku të përcaktohet adresa e saktë e objektit (Njësia Administrative, Rruga, nr. i objektit, etj.); - Dokument identifikimi i subjektit kërkues, adresa e saktë e banimit, adresë elektronike komunikimi në rast njoftimi dhe/ose nr. kontakti);- Dokument pronësie (Çertifikatë pronësie e lëshuar nga ASHK ose Akt-Shitblerje para noterit). Në rast, se nuk disponohet asnjë dokument pronësie, duhet të dorëzohet dokument që vërteton, se aplikanti është posedues në mirëbesim i objektit, provuar me vërtetim apo vetëdeklarim nga ASHK dhe/ose Njësia Administrative përkatëse; -Deklarata personale që për objektin, nuk ka kontratë furnizimi me ujë; Foto të objektit.*

4. PROCEDURA PAS DEPOZITIMIT TË APLIKIMIT/DOKUMENTACIONIT DHE ZBATIMI I PROJEKTIT

4.1 Me depozitimin e kërkesës/aplikimit, UKT sh.a shqyrton nëse dokumentacioni dhe informacioni i paraqitur nga aplikuesi është i plotë dhe nëse kërkuesi ka detyrime të papaguara ndaj UKT sh.a.

4.2 Në rast, të detyrimeve të pashlyera, strukturat e UKT sh.a njoftojnë Aplikuesin në adresën zyrtare, për detyrimet përkatëse apo mangësitë në dokumentacion dhe kërkon plotësimin dhe/ose pagesën e tyre brenda jo më shumë se 5 (pesë) ditëve pune nga data e marrjes dijeni të njoftimit.

4.3 Kur subjekti/aplikanti njofton për likuidimin e detyrimeve dhe/ose plotëson mangësitë në dokumentacion, UKT sh.a fillon procedurën për hartimin e projektit të pikës së lidhjes së furnizimit me ujë dhe/ose pikës së shkarkimit në sistemin e kanalizimeve.

4.4 Me miratimin e projektit dhe preventivit pikës së lidhjes së furnizimit me ujë dhe/ose pikës së shkarkimit në sistemin e kanalizimeve, UKT sh.a njofton subjektin kërkuar për kryerjen e pagesës së vlerës së preventivit të pikës së lidhjes me rrjetin publik të furnizimit me ujë dhe/ose pikës së shkarkimit në sistemin publik të kanalizimeve për punime që do të kryhen nga UKT sh.a dhe vlerës së kontratës/ve provizore ose definitive sipas kërkesës.

4.5 Pas kryerjes së pagesës, sipas vlerës së preventivit, Aplikuesi realizon shtrimin e tubacionit deri tek pjesa e projektit që të miratuar nga UKT sh.a që do të kryhen prej tij, deri tek pika e furnizimit me ujë dhe/ose pika e shkarkimit që do të realizohet nga specialistët e UKT sh.a për zbatimin e projektit të pikës së lidhjes me rrjetin publik të furnizimit me ujë dhe/ose shkarkimit në sistemin e kanalizimeve.

4.6 Zbatimi i të gjithë projektit të furnizimit me ujë të pijshëm dhe/ose pikë shkarkimi me rrjetin e kanalizimeve të ujrave të ndotura do të mbikqyret nga struktura e UKT sh.a që zbaton projektin në emër të shoqërisë.

4.7 Për lëshimin e **Aktit të Kolaudit**, subjekti aplikon pranë UKT sh.a, shoqëruar me dokumentacionin në 2 (dy) kopje, si vijon: - *Kërkesë*; - *Autorizim shoqëruar me dokument identifikimi të personit që aplikon, në rast, se është i ndryshëm nga përfaqësuesi ligjor i subjektit juridik*; - *Leje ndërtimi dhe plan vendosje të objektit*; - *Kopje të projektit të hartuar dhe miratuar nga UKT sh.a. për pikë lidhje me rrjetin e ujësjellësit dhe/ose pikë shkarkimi me rrjetin e kanalizimeve të ujrave të ndotura. Në rast, të mungesës së projektit të miratuar nga UKT sh.a. për shkarkimin në rrjetin e kanalizimeve, duhet të paraqesë miratimin nga ish komuna për pikë shkarkimi ose gropë septike.* Në rast, se Aplikuesi nuk ka aplikuar më parë për projekt për pikë lidhje me rrjetin e ujësjellësit dhe/ose për pikë shkarkimi me rrjetin e kanalizimeve të ujrave të ndotura, dokumentacioni shoqëruar i kërkesës për miratimin e Aktit të Kolaudit do të jetë i njëjtë me atë të depozituar për miratim pikë lidhje FUP dhe pikë shkarkimi në Kanalizimet e ujrave të ndotura. Pas marrjes së aplikimit për Akt – Kolaudit, strukturat e UKT sh.a verifikojnë nëse ka projekt të zbatuar për pikë lidhje në dhe/ose shkarkimi dhe nëse kërkuesi ka detyrime të papaguara ndaj shoqërisë. Në rast, të mungesës së këtyre projekteve Akt-Verifikimi lëshohet negativ. Në rast se konfirmohen detyrime ekzistuese dhe kushte të paplotësuara, UKT sh.a njofton subjektin për shlyerjen dhe plotësimin e tyre brenda një afati të pranueshëm. Nëse për aplikuesin është miratuar projekt, vijon procedura për paisje me akt - kolaudit. Kur tarifa e Akt – Kolaudit nuk është përfshirë në preventivat dhe projektet e miratuara të ujësjellësit dhe kanalizimeve, ndaj aplikuesit lëshohet fatura përkatëse. Akt-Kolaudimi i pikës së lidhjes të furnizimit me ujë dhe/ose pikës së shkarkimit në sistemin e kanalizimeve, do të miratohen, vetëm pasi të ketë përfunduar procesi i lidhjes së kontratave të objektit dhe nëse është zbatuar projekti i miratuar të pikës së lidhjes dhe/ose shkarkimit sipas Kushteve Teknike të Zbatimit.

4.8 Në rastet e kërkesave për spostime të rrjeteve, që ndodhen brenda një ose më shumë pronave për efekt zhvillimi/ndërtimi, në varësi të specifikave që paraqiten për zgjidhje nga UKT sh.a. për zbatimin e tyre, përgatitet projekti përkatës në të cilin përcaktohen detajet teknike të spostimit dhe pikat takuese të tij.